VENDIM
Nr. 275, datë 2.5.2019

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR KATEGORIZIMIN E OBJEKTEVE SHTETËRORE, SIPAS MËNYRËS SË RUAJTJES E TË SIGURIMIT FIZIK TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të shkronjës "gj", të pikës 1, të nenit 18, të ligjit nr. 75/2014, "Për shërbimin privat të sigurisë fizike", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objektet në pronësi, administrim apo përdorim të subjekteve publike, në vijim "objektet", kategorizohen në objekte, ruajtja dhe sigurimi i të cilave realizohet:

a) nga shërbime të specializuara për ruajtjen dhe sigurinë fizike;

b) nga punonjës të trajnuar për ruajtjen dhe sigurinë fizike të vetë subjektit publik;

c) me sisteme vëzhgimi dhe/ose sinjalizimi.

Nuk janë objekt i këtij vendimi objektet e rëndësishme shtetërore, që ruhen dhe sigurohen nga Policia e Shtetit apo Garda e Republikës.

2. Nevoja dhe mënyra e ruajtjes dhe sigurimit fizik të objekteve përcaktohet, kryesisht, nga rëndësia dhe lloji i objektit, vendndodhja, veçoritë specifike, dokumentacioni që administrohet, rreziqet e mundshme si dhe cilësitë e veçanta të personave që ushtrojnë veprimtarinë në këto objekte.

3. Objektet sigurohen nga shërbime të specializuara për këtë qëllim, kur:

a) kanë qenë objekt i ngjarjeve kriminale, që kanë cenuar ushtrimin e veprimtarisë gjatë pesë viteve të fundit;

b) në mjediset e tyre administrohen vlera monetare;

c) në mjediset e tyre administrohet dokumentacion i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm;

ç) në to zhvillohet veprimtari, e cila mund të jetë objekt sulmi nga elementë kriminalë;

d) në mjediset e tyre ushtrojnë veprimtarinë persona, të cilët, për shkak të funksionit, mund të jenë subjekt sulmi nga elementë kriminalë;

dh) ndodhen larg qendrave të banuara dhe mundësia e reagimit të shërbimeve të Policisë së Shtetit në një kohë të shpejtë është e kufizuar;

e) cenimi i sigurisë së tyre mund të sjellë rrezik të shtuar për shëndetin e njerëzve dhe sigurinë publike, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, përmbytje, shpërthime, zjarre masive, përhapjen e lëndë radioaktive apo toksike.

4. Objektet sigurohen me punonjës shërbimi të subjektit, kur:

a) në mjediset e tyre nuk administrohen vlera monetare ose arkiva të rëndësishme;

b) ushtrojnë veprimtari, e cila nuk përbën burim rreziku për ngjarje kriminale;

c) në mjediset e tyre ushtrojnë veprimtarinë persona, të cilët nuk kryejnë funksione që mund të përbëjnë rrezik potencial sulmi nga elementë kriminalë;

ç) ndodhen në qendrat e banuara;

d) nevoja për siguri apo ruajtje është e domosdoshme vetëm gjatë orareve zyrtare të ushtrimit të veprimtarisë.

5. Objektet sigurohen me sisteme vëzhgimi dhe/ose sinjalizimi kur:

a) fushëpamja e mjedisit/sipërfaqes ku zhvillon veprimtarinë subjekti mbulohet tërësisht nga sistemet e vëzhgimit me kamera;

b) ushtrojnë veprimtari, e cila nuk përbën burim rreziku për ngjarje kriminale;

c) në mjediset e tyre zhvillohet veprimtari e kufizuar;

ç) kanë akses në infrastrukturë rrugore dhe reagimi i grupeve të gatshme të shërbimeve të specializuara është i shpejtë;

d) stacionet e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndodhen larg tyre;

dh) ndodhen brenda territorit të kompleksеve të objekteve që sigurohen nga shërbime të specializuara.

6. Për përcaktimin e nevojës dhe të mënyrës së ruajtjes e sigurimit fizik të objekteve, brenda 30 ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, me urdhër të ministrit të Brendshëm krijohet Komisioni i Sigurisë së Objekteve, i përbërë nga punonjës të Ministrisë së Brendshme, Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës.

7. Titullarët e ministrive, të institucioneve, agjencive apo njësive/strukturave të tjera shtetërore/publike, brenda 30 ditëve, nga krijimi i Komisionit të Sigurisë së Objekteve, paraqesin pranë tij kërkesë për vlerësimin e nevojës për ruajtje dhe sigurim për objektet shtetërore në pronësi, administrim apo përdorim të tyre.

8. Kërkesa përmban përshkrimin e objekteve, arsyetimin për përmbushjen e kritereve dhe për përfshirjen e objektit specifik për ruajtje dhe sigurim në një nga kategoritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

9. Komisioni i Sigurisë së Objekteve shqyrton kërkesën për vlerësimin e nevojës për ruajtje dhe sigurim të objekteve dhe në përfundim, me vendim të arsyetuar, miraton ose kundërshton kërkesën. Në rast miratimi, komisioni kategorizon objektet në një nga kategoritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi. Kategorizimi i kryer mund të jetë i ndryshëm nga ai i kërkuari.

10. Titullarët e ministrive, të institucioneve, agjencive apo njësive/strukturave të tjera shtetërore/publike marrin të gjitha masat për zbatimin e vendimeve të Komisionit.

11. Ngarkohen ministritë, agjencitë dhe institucionet e tjera publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama